



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. _____ prot

Tiranë, më ____ . ____ .2009

U D H Ë Z I M

Nr. 39, datë 24.09. 2009

PER
TARIFAT E SHPERBLIMIT TE PERSONAVE QË AKTIVIZOHEN NË PROCESIN
E KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Në zbatim të nenit 20 të ligjit Nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të pikës 19, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 886, datë 19.12.2007 “Për krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit të kualifikimit për çertifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të rregullores Nr. 2091, datë 04.03.2008 “Për rregullat dhe procedurat e provimit dhe riprovimit për çertifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të urdhërit Nr. 75, datë 05.06.2008, të Ministrisë të Financave për miratimin e rregullores “Për rregullat dhe procedurat e provimit të formimit për çertifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik”, si dhe akteve të tjera që lidhen me procesin e kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit,

URDHËZOJ:

1. Për të siguruar zhvillimin normal të trajnimit dhe kualifikimit të vijueshëm të detyruar dhe përditësuar për audituesit e brendshëm në sektorin publik me cilësi dhe nivel sa më të lartë profesional, Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit, me propozim të drejtuesit që mbulon edukimin pranë DPA; lidh me referuesit (trainerët) një apo disa nga tipet e këtyre Kontratave:

- a-Kontratë për trainimin e referuesve (trainerëve);
- b-Kontratë për trainimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik;
- c-Kontratë për hartimin e kurrikulave dhe materialeve të tjera trajnuese;

2. Referuesit (trainerët) ndahen në 3 (tre) kategori si vijon:

- a-Referues (trainer) të kategorisë së ulët. Në këtë grup përfshihen të gjithë referuesit që kanë deri në 5 vjet eksperiencë pune në fushën përkatëse;
- b-Referues (trainer) të kategorisë së mesme. Në këtë grup përfshihen të gjithë referuesit që kanë një eksperiencë pune nga 5 deri në 10 vjet në fushën përkatëse;
- c-Referues (trainer) të kategorisë së lart. Në këtë grup përfshihen të gjithë referuesit

që kanë mbi 10 vjet eksperiencë pune në fushën përkatëse ose kanë mbrojtur një gradë shkencore.

3. Tarifat e pagesave per referuesit (trajneret) shënohen edhe në kontratë dhe llogariten në bazë ditore ose në bazë ore, në varësi të kategorisë së referuesit (trajnerit) si më poshte:

- a. Për kontratat e parashikuara në piken 1, shkronja “a” dhe “b” tarifa ditore e plotë do të paguhet për zhvillimin e një dite me 6 orë trajnim, sipas tabelës Nr.1, të lidhjes Nr.1, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij udhëzimi.
- b. Për kontratat e parashikuara në piken 1, shkronja “c” tarifa ditore e plotë do të paguhet për hartimin e korrikulave apo materialeve të trajnimit të nevojshëm për zhvillimin e 6 orëve trajnim, sipas tabelës Nr.2, të lidhjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij udhëzimi.
- c. Në rastet e hartimit të korrikulave apo materialeve të trajnimit si dhe trajnimeve për më pak se 6 orë, pagesa llogaritet në përpjestim me orët e trajnimit.

4. Tarifat e pagesave për zhvillimin e konsultimeve dhe për hartimin e tezave të provimit për çdo lëndë do të jenë si më poshte:

- a. Lektori që zhvillon konsultime me kandidatët që plotësojnë kushtët për të hyrë në provim paguhet me 1500 lekë per çdo orë konsultimi.
- b. Anëtari i komisionit për çdo provim qe jepet per likujdimin e detyrimeve për çdo lëndë sipas programit të miratuar nga Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm, paguhet 10000 lekë për hartimin e 40-50 pyetjeve të cilat i dorzohen Komisionit të kualifikimit mëngjesin e ditës së provimit për të hartuar testin përfundimtare të provimit.

5. Tarifat e pagesave për korigjuesit e tezave (testeve apo fletoreve) të provimit, për mbikqyrësit e sallave dhe personelin mbështetës (sekretimi i fletoreve të provimit dhe shoqërimin e bazës materiale për provimet) për çdo lëndë do të jenë si më poshte:

- a. Korigjuesi i testeve paguhet me 180 lekë për cdo fletore (test) të korigjuar.
- b. Mbikqyrësit e sallave paguen me 3000 lekë për çdo mbikqyrje provimi
- c. Personeli mbështetës që aktivizohet në procesin e provimeve, paguhet 3000 lekë në ditë.

6. Tarifat e pagesave për zhvillimin e provimeve të formimit do të jenë si më poshte:

- a. Anëtarët e Komisionit të kualifikimit paguhet 10000 lekë për hartimin e 40-50 pyetjeve që do të përzgjidhen nga komisioni për zhvillimin e provimit të formimit gjatë gjithë sezonit për të gjitha ditët e provimit sipas grupeve me përbërje nga 25 -30 kandidatë.
- b. Anëtari i komisionit për çdo ditë që merr pjesë në provimin e formimit paguhet me 10000 lekë ndersa sekretari i komisionit të kualifikimit paguhet me 6000 lekë në ditë

7. Shpenzimet që do të kryhen në zbatim të këtij udhëzimi përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë e financave për programin e miratuar për “Auditimin e brendshëm dhe kontrollin e financave publike”.

8. Shpenzimet për të gjitha operacionet që lidhen me procesin e kualifikimit të vijueshëm dhe të detyrueshëm për audituesit e brendshëm në sektorin publik evidentohen dhe përlogariten në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, nga struktura përkatëse e ngarkuar për edukimin (trajnimin dhe kualifikimin) në DPA dhe pasi miratohen nga drejtuesi i kësaj njësie dhe Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit me shkresë zyrtare, dergohen për pagesë në sektorin e buxhetit.

9. Urdhëri Nr.3/1, datë 19.08.2004 “Për shpërblimin e Anëtarve të Komisionit Shtetërorë dhe lektorve për kualifikimin e Auditve të brendshëm në sektorin publik“ shfuqizohet

10. Për zbatimin e kësaj Udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve mbështetëse, Drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brendshme dhe Sektori i financës dhe i buxhetit.

Ky urdhëzim hynë në fuqi menjëherë. Efektet financiare që lidhen me zbatimin e pikës Nr 3, të këtij Udhëzimi fillojnë nga data 1 Janar 2009 e në vazhdim, ndërsa efektet financiare që lidhen me zbatimin e pikave të tjera të këtij Udhëzimi hynë në fuqi në Shtator të vitit 2009 e në vazhdim.

Ridvan BODE

MINISTER

LIDHJA Nr.1

TARIFAT E PAGESVE PER REFERUESIT (TRAJNERET)

Tabela Nr.1

KATEGORIA E REFERUESVE (TRAINERVE)	TARIFA DITORE NË LEKË	TARIFA PËR NJË ORË NË LEKË
I ulët	4500	750
I mesem	6000	1000
I lartë	9000	1500

Tabela Nr.2

KATEGORIA E REFERUESVE (TRAINERVE)	TARIFA DITORE NË LEKË	TARIFA PËR NJË ORË NË LEKË
I ulët	7200	1200
I mesem	9000	1500
I lartë	13000	2166

Drejtori i Pergjithshem i Auditimit

Pajtim SHEHU